



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KUVENDI I KOMUNËS KOMITETI PËR POLITIKË DHE FINANCA

Procesverbal i mbajtur më 12 maj 2023, në mbledhjen e XII-të (dymbëdhjetë) mandati VII-të i Komitetit për Politikë dhe Financa.

Mbledhja u mbajt në sallën e mbledhjeve të Kuvendit në ndërtesën e re të Komunës, dhe filloi në orën 10:15.

Mbledhjen e hapi dhe kryesoi z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Kuvendit, përkatësisht i këtij Komiteti.

Fillimisht u konstatua se në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtarët e këtij Komiteti, dhe atë; (Naim Çunaku; Qëndrim Softolli; Arnisa Sylejmani; Haki Rudari; Drita Pajaziti; Sebastina Vokri; Bashkim Sylja; dhe Mrika Thaçi) bashkëngjitur lista e nënshkrimeve.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi për punë.

Në mbledhje i pranishëm ishte edhe; znj.Marigona Lahu Nënkyetare e Komunës; znj.Adelina Stublla, Drejtore e Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale-DSHMS; z.Pajtim Balaj Drejtor i Drejtorisë së Kulturës Rinisë dhe Sportit-DKRS; znj.Saranda Stublla, Drejtore e Drejtorisë së Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ, dhe z.Liman Zeqiri, shef i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK Podujevë.

Rendi i ditës

z.Hilmi Hoxha, Kryesues i Komitetit, e hapi mbledhjen duke i përshëndetur të pranishmit dhe duke i'u dëshiruar mirëseardhje, konstatoi kuorumin, ndër të tjera theksoi, thirrja dhe materiali i kësaj mbledhje ju është dërguar me kohë, thënë të vërtetën me e-maile private të juaja po kemi paksa vështirësi t'ju dërgojmë materialet dhe kjo sigurisht për shkak të volumit të madh të materialeve, mirëpo të paktën thirrjen jua kemi dërguar, ndërsa në e-mailet zyrtare ju është përcjellë të gjithëve thirrja dhe materiali për këtë mbledhje por edhe për atë të Kuvendit e cila është caktuar të mbahet më 15 maj 2023.

Para se të fillojmë me rendin e ditës dëshiroj t'ju njoftoj se kemi një kërkesë e cila i është drejtuar Kryetarit të Komunës, si dhe Kuvendit të Komunës, kërkesa është nga Klubi "Afrim Zhitia" i cili ka mbajtur një mbledhje më 07.05.2023 dhe sipas tyre thuhet që unanimisht kanë vendosur që t'i drejtohem Kuvendit të Komunës për të nderuar zonjën ish eurodeputete Doris Pack, me titullin Qytetare e Nderit e Podujevës, si dhe emërtimin e një rruge kryesore me emrin e saj, ndërsa arsyetimi i tyre është, po citoj, *Doris Pack që nga viti 1989 e deri në ditët e sotme i ka përkrahur interesat e Popullit Shqiptar në Parlamentin Europian dhe në Institucionet tjera. Që nga vitit 1989 e deri më 1994 si eurodeputete ishte anëtare e relacioneve me ish Jugosllavinë, kurse nga viti 1994 ky Grup Parlamentar do të quhet Delegacioni për Europën Jug-Lindje e që Doris Pack emërohet Presidente.*

Doris Pack ka qenë iniciatore e shumë rezolutave të Parlamentit Europian në favor të Kosovës.

Që nga viti 1989 e deri në ditët e sotme të gjitha personalitetet politike nga Kosova duke filluar nga Adem Demaçi, Rexhep Qosja, Ibrahim Rugova, Ramush Haradinaj, Hashim Thaqi, Albin Kurti, të gjithë janë pritur në zyrën e kësaj eurodeputete. Pra Doris Pack është ndër mikeshat më të mira që ka Populli Shqiptarë.

Pra kjo është kërkesa e Klubit Politik "Afrim Zhitia" që ne në një mbledhje të ardhshme ta shpallim Doris Pack Qytetari e Nderit e Podujevës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën.

z.Haki Rudari, theksoi, unë e dëgjova kërkesën e Kryesuesit për futjen në rend të ditës që eurodeputetja Doris Pack të shpallet Qytetare nderi dhe të merre mirënjohje nga Kuvendi i Komunës së Podujevës, ne Grupi i LVV-ës e përkrahim fuqishëm për arsye se ne disa prej gjeneratave më të moshuar jemi në dijëni për aktivitetin e saj që ka bërë në vitet e 90-ta dhe lobimin që ka bërë në vende të ndryshme perëndimore për interes të Kosovës e që atëherë kur më shumti Kosova kishte nevojë për përkrahje, andaj mendoj se është një ide e qëlluar dhe do ta ketë përkrahjen edhe në seancën e Kuvendit të Komunës.

z.Naim Çunaku, theksoi, të flasësh për personalitetin e një politikaneje e cila padyshim ka dhënë një kontribut të çmuar e që ne sigurisht se do ta vlerësojmë këtë kontribut të eurodeputetes Doris Pack, mirëpo forma se po tentohet dhe siç po paraqitet nuk do të doja të na bëhet praktikë në Kuvendin e Komunës për shkak se në rend të parë Komuna e Podujevës duhet ta ketë një rregullore për trajtimin e personaliteteve, duhet të ketë një komision të ngritur për ata që përmbushin ato që parashihen në rregullore, pastaj është e ditur se si procedohen kërkesat në adresë të një institucioni e që është forma përmes peticionit, kurse siç u prezantua unë vërejtja se është vetëm një Grup Politik që është “Afrim Zhitia”. Ne sot mundemi të veprojmë, por mund të hasim pastaj në kërkesa më të ndryshmet, dhe nëse ato nuk e tejkalojnë një filtër siç e potencova një komision të ngritur prej këtij Kuvendi për dhënie apo zënie të ndonjë emër të çmuar të skenës politike, atdhetare etj të ngjashme, që Kuvendi e mendon se duhet të zë vendin në historinë gjegjësisht vend në Komunën e Podujevës si vend si trajtohet me dinjitet ai emër, prandaj frikohem që kjo formë pastaj do të na qoj në një rrugë që nuk do të mund t’i dalim në krye.

Në seancën e kaluar patëm zhurmë të madhe lidhur me iniciativa individuale pa u respektuar infrastruktura ligjore, unë nuk po mund t’i kuptoj disa gjëra sepse nuk jemi shoqëri që veprojmë ad-hoc sipas qejfeve, tekeve apo meritave të ndokujt por duhet ta kemi të bazuar në ligj dhe në procedurë për gjithçka që bëjmë, prandaj më vie keq që për një person me epitete siç është Doris Pack, t’i them këto mëdyshje e që nuk e kam për personalitetin e saj për të çka unë konsideroj se e nderojmë vetveten e lëre më atë, mirëpo kjo formë do të na qoj në një rrugë ku një ditë nuk do të mund të dalim prej saj. Pra mendoj se në rend të parë duhet ta formojmë komisionin për ndarjen e dekoratave gjegjësisht trajtimin e kërkesave për personalitete. Të futet me nguti sot dhe që Kuvendi i Komunës të merr vendim që një rrugë t’i jepet emri, konsideroj se edhe z.Haki Rudari ka qenë në komision dhe anëtar i këtij Kuvendi kur janë emërtuar rrugët dhe sigurisht është në dijëni se janë procedurat, janë standardet dhe gjëra tjera për emërtimin e një rruge, prandaj nuk do të doja të ngutemi në këtë aspekt edhe pse nuk do të votoj kundër kësaj çështje.

Qasja e Grupit Politik “Afrim Zhitia” në deklaratën përkatëse të tyre drejtuar Komunës, sigurisht është çështje e tyre mirëpo renditja siç ishte për kontributin e Doris Pack, ishte e njëanshme dhe e ngjyrosur, në veçanti kur u përmenden personalitetet që ka pritur Doris Pack ngase ta vësh emrin e kryetarit të shtetit dhe kryetarit të një subjekti politik që i ka prirë pothuajse një dhjetëvjeçari, pas personaliteteve që nuk i afrohen, është e papranueshme, dhe për këtë nëse dëshironi po foli konkretisht, por besoj se u kuptua kjo. Pra ai arsyetim për mua nuk ishte me vend, andaj në këtë rast ne do të abstenojmë, dhe nuk mendoj se është mirë që me nguti duhet ta fusim në rend të ditës.

z.Bashkim Sylja, theksoi, mendoj se është mirë të trajtohet si çështje pasi veç kërkesa është adresuar tek ne, mirëpo ne do ta votojmë këtë sot që të futet si pikë shtesë e rendit të ditës kurse në seancën e Kuvendit është mirë që Ekzekutivi i Komunës, meqë kërkesa i është drejtuar asaj, të na jap sqarime konkrete për cilën rrugë bëhet fjalë, të ketë debat dhe pastaj të vendoset për këtë çështje se a do të kaloj apo jo me vota.

z.Haki Rudari, theksoi, dëgjova kolegët parafolës dhe nëse i vetmi problem është renditja e atyre që Doris Pack është takuar mendoj se nuk diçka e madhe, madje edhe mund ta përmirësojmë.

Sa i përket asaj që e potencoj kolegu parafolës z.Bashkim Sylja, kjo nuk ka të bëjë me emërtim të rrugës por vetëm që e përmendura të shpallet Qytetare nderi e Komunës së Podujevës fillimisht e pastaj për emërtim të ndonjë rruge konsideroj se është diçka tjetër që do ta trajtoj një komision i veçantë.

Pra që e përmendura të shallet Qytetare Nderi është çështje e ligjshme, kërkesa është plotësisht në pajtim me ligj dhe me rregullore dhe nuk ka kurrfarë shkelje këtu, kurse për emërtimin e rrugës atëherë duhet të formohet një komision për emërtimin e rrugëve e që kjo do të thotë se mund ta bëjmë në të ardhmen, mirëpo për t'u shpall Qytetare e Nderit nuk ka kurrfarë pengese ligjore.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që Kryesuesi i Kuvendit e lexoj, kërkesa ishte në pako për rrugë dhe për Qytetare Nderi. Në fillim e potencova dhe sërish po e përsëris se nuk do të ndihem rehat po të mos jem përkrahës që ta nderojmë një eurodeputete siç është Doris Pack, por të mos mundohemi që në emër të eurodeputetes Doris Pack, këtë çështje ta ngjyrosim me të bërat tona.

Pra unë nuk kam votë kundër që kjo zonjë të shpallet Qytetare Nderi dhe këtë e potencova edhe më parë se unë konsideroj se së pari ne e nderojmë vetveten me nderimin e një personaliteti dhe duke i'a njohur kontributet që ka bërë për vendin, mirëpo ashtu siç e ceka mendoj se jemi duke hyrë në një fazë që nuk do të mund t'i dalim në krye, me këto veprime sepse nesër/në të ardhmen mund të ndodh diçka tjetër, pra në rend të parë nuk është mirë, prandaj e them se do të ishte mirë që kjo çështje të shtyhet për një seancë tjetër, të formohet një komision për çështje të tilla. Këtë e them duke mos e kontestuar fare personalitetin e Doris Pack, mirëpo ta vëm një rregull se si mundet dhe cilat procedura duhet të përmbushen për veprime të tilla nga ana e Kuvendit të Komunës.

z.Bashkim Syla, theksoi, mendoj se nuk është çështje për të cilën duhet bërë kaq shumë zhurmë. Unë specifikisht kërkoja që çdo iniciativë dhe çdo vendim që mund të merret të jetë në bazë ligjore, kështu që ne sot mund ta fusim pikë të rendit të ditës dhe të njëjtën ta rekomandojmë për seancën e Kuvendit ku edhe mund ta diskutojmë, por të mos ngutemi dhe të dalim keq pastaj sepse jemi në dijeni që për të krijuar komision për emërtime të rrugëve fillimisht duhet pas parasysh ankesat që janë nga emërtimi që ka ndodh e që është një numër i madh i tyre, kështu që duhet ta shtjellojmë këtë çështje dhe në fund të jemi preciz në mënyrë që të mos kemi kontradikta në këtë aspekt ngase kemi shumë kërkesa për të rishikuar emrat e rrugëve, kështu që ne kur ta formojmë një komision të tillë nuk mundemi pastaj të mos i trajtojmë ato kërkesa të mëparshme. Pra kërkesa duhet të sjellët në mënyrë specifike dhe e qartë nga Ekzekutivi i Komunës në bashkëpunim me Zyrën ligjore.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa për sqarimin e juaj, Drejtoria e Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit e ka formuar një komision për shqyrtimin e atyre ankesave që kanë qenë për emërtimin e rrugëve, madje kjo çështje është kërkuar që të bëhet nga Kuvendi i Komunës por që ne si Kuvend nuk kemi pranuar ta bëjmë, dhe tani ta shohim se çfarë po ndodh në atë proces, mirëpo unë po e shoh si problem emërtimin e një rruge me emrin e Doris Pack, por problemi qëndron tek çështje e shpalljes së saj Qytetare Nderi e që kolegu z.Naim Çunaku ka të drejtë kur e thotë se duhet ta kemi një rregullore dhe ta kemi një komision për çështje të tilla. Ne nuk po mund të vlerësojmë drejtë sepse pastaj nuk po mundemi askush të dalim kundër një kërkesë të tillë ngase as unë e as askush tjetër nuk kemi të drejtë morale të dalim kundër Doris Pack sepse jemi në dijeni për kontributin e saj, kështu që mendoj se është mirë që ne sot ta fusim në rend të ditës këtë pikë, t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim dhe pastaj në seancën e Kuvendit mund edhe ta formojmë një komision për këtë çështje dhe ndoshta edhe për çështje tjera të kësaj natyre, komision të cilin do ta zgjidhnim prej personave sa më profesionistë.

Sa i përket radhitjes së emrave që u cek nga z.Naim Çunaku, është çështje që është bërë nga Klubi i cekur dhe nuk dua të debatoj për këtë, pra nuk është gabim apo faj i askujt këtu, prandaj do të ishte mirë të votohej kjo çështje dhe t'i rekomandohej Kuvendit për diskutim.

z.Naim Çunaku, theksoi, për qëllimin më të mirë e kërkoja fjalën dhe kjo të mos konsiderohet në ndonjë mënyrë tjetër, dëgjova që për emërtim të rrugëve Drejtoria përkatëse ka formuar komision dhe pyes në çka e ka bazuar, Drejtoria nuk mund të revidoi vendimet e Kuvendit, por është ka ndodh është duke ndodhur gjithçka dhe nuk po hamendem asgjë.

Sa i përket asaj që kolegu z.Bashkim Sylja e ceku rreth komisionit për emërtimin e rrugëve, unë e pata poentën që me legjislacionin në fuqi dhe praktikën që janë, Komuna, Kuvendi i Komunës duhet ta ketë një komision, jo për rrugë, por për vlerësimin e personaliteteve që dëshiron t'i inkorporoj si pjesë të historikut të vetë për kontributin e tyre për vendin, për Komunën, për Kombin, pra jo vetëm komision për rrugët por komision që duhet ta përcaktoj atë, kjo ngase shembull, çka nëse ndokush na e sjellë nesër ndonjë kërkesë ashtu siç ka ndodhur në komision të rrugëve ku ka pas individ që kanë sjellë kërkesa të tilla për ndonjë person i cili në një periudhë të tij ka pas një periudhë të shndritshme por që në anën tjetër ka pasë periudhë jo të shndritshme, prandaj duhet të jetë një komision vlerësues për çështje të tilla, prandaj e them se mos po hymë në hak (gjynah) me ndokënd apo mos po teprojmë me ndokënd. Pra në këtë kontekst e kisha fjalën unë dhe atë pa kurrfarë ngjyrimi, por vetëm e vetëm për një punë dhe për një pasqyrë që do të krenoheshim që kemi bërë diçka për Podujevën dhe për ata që e kanë ndihmuar Podujevën dhe vendin, andaj këtu ishte poenta dhe aksesi im, por jo për ngjyrimë ose ngatërrime, vetëm e vetëm që ne të jemi ata që duke e nderuar ndokënd të mos e dëmtojmë ndokund, fundja ata emra e nderojnë vetveten për kontributin që e kanë bërë për neve.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, në këtë kontekst si Kryesuesi i Kuvendit ju informoj se kam 4-5 kërkesa për shtatore, por që unë nuk kam mundur t'i arsyetoj ende ato që t'i sjellë në Kuvend, kjo është arsyeja dhe nuk po dëshiroj ta fus në këtë temë drejtorin e DKRS-së z.Pajtim Balaj, mirëpo tek këto vendimet që i marrim ne si Kuvend për t'i shpallur personalitete të caktuara Qytetar Nderi, të jemi të kujdesshëm sepse me figura të tilla nuk kemi të drejtë të luajmë, këtu është problemi ndërsa për mënyrën se a është mirë ne sot t'i rekomandojmë Kuvendit për diskutim dhe ta dërgojmë në Kuvend për formimin e një komisioni më shumë profesional sesa politik që t'i vlerësoj këto figura, dhe atëherë ne ët marrim një vendim në bazë të propozimit edhe të tyre sepse Shoqatat mund të sjellin emra të kujtdo qoftë dhe nuk e kontestojmë këtë, mirëpo mund ta sjellën edhe emra tjerë që ndoshta na duhet t'i kundërshtojmë, e që sigurisht se mund të dalim keq pastaj, kështu që është mirë të mos i'u jepet mundësi në Kuvend të sjellën emra që ndoshta nuk e meritojnë, ose edhe kur e meritojnë ta kemi edhe një rekomandim shtesë prej një komisioni e që do të ishte më e drejtë kjo qasje.

z.Naim Çunaku, theksoi, vetëm sa për një plotësim të Kryesuesit dhe krejt me dashamirësi ngase nuk jam unë ai që duhet të vlerësoj dikë, mirëpo imagjinojeni një situatë kur ndonjë personalitet i caktuar të shpallet Qytetar Nderi duhet t'ia përmendesh dhe numërosh enkas prej cilit vit në cilin vit të gjitha, dhe tani kush mendon se është e mundshme t'ia ndryshoj diçka tek një personalitet, prandaj e them se a është e mundshme të ketë një qasje tjetër, a është në rrezik kjo, prandaj e them se duhet të jetë e përcaktuar për cilën periudhë kohore dhe për kontributin e cilës periudhë kohore, sepse gjërat mund të ndryshojnë dhe nuk është kjo çështje bash ashtu e thjesht qysh po mundohemi ne ta shohim.

z.Pajtim Balaj, Drejtor i DKRS, theksoi, edhe pse ndoshta paksa jashtë temës por meqë u përmend çështja e shtatoreve, ne e kemi një dokument i cili na është sjellë prej Ministrisë së Pushtetit Lokal në të cilin thuhet se në momentin e votimit të Hartës Zonale të Komunës, procedura e caktimit të lokacionit shkon tek Drejtoria e Urbanizmit dhe jo në Kuvendin e Komunës, andaj për këtë arsye kërkesat e ngjashme për shtatore nuk përse të sjellën në Kuvend duke marrë për bazë atë dokument që na është kthyer prej Ministrisë së cekur. Në bazë të Hartës Zonale të Komunës kërkohet leja e ndërtimit apo jo të saj, dhe kaq, përndryshe çështja e shtatoreve është duke eskaluar sepse ne vetëm në luftën e fundit kemi 150 Dëshmorë/e, ndërsa kemi me mijëra Dëshmorë/e gjatë historisë dhe të gjithë kemi ndonjë babagjysh dhe ndonjë të afër që kemi dëshirë ta bëjmë hero, mirëpo është mirë t'i ndihmojmë njëri tjetrit dhe qytetit sepse nuk mund ta bëjmë Podujevën sikurse Shkupin ne këtu. Janë disa figura Kombëtare pak më të mëdha që duhet t'i nderojmë dhe janë nga të gjitha krahët politikë, por nuk mundemi ne tani të gjithë. Ashtu siç e ceku edhe Kryesuesi i Kuvendit po vërshojnë kërkesa qoftë në zyrën e Kryesuesit qoftë në DKRS po vërshojnë kërkesa nga më të çuditshmet, madje deri aty sa jo zyrtarisht kanë ardhur që të ndahet

edhe shtatorja e Zahir Pajazitit nga 3 Heronjtë tjerë që janë të vendosur ne Shesh, dhe të vendoset diku tjetër, andaj mendoj se për këto tema meqë edhe bazën ligjore e kemi, të mos sjellën në Kuvend, sidomos për vendosjen e shtatoreve meqë edhe ligjërisht ne mund të kërkojmë leje në Drejtorinë e Urbanizmit për figura pak më të mëdha që kanë lënë gjurmë Kombëtare qoftë të mëhershme qoftë të mëvonshme.

z.Bashkim Sylja, theksoi, si duket kolegu z.Naim Çunaku më keqkuptoj në atë që e caka më herët sepse unë nuk e kisha fjalën për komision, pra plotësisht jam në dakord që të krijohet një komision për trajtimin e këtyre kërkesave për shpalljen Qytetar Nderi i Komunës së Podujevës, mirëpo ajo që unë e ceka kishte të bënte me rrugën e që nëse vendosim ta emërtojmë ndonjë rrugë me emrin Doris Pack atëherë duhet të formohet një komision për këtë çështja, andaj për këtë unë kam dyshime dhe e potencova se duhet të kemi kujdes me këtë çështje në mënyrë që të mos biem ndesh edhe me kërkesat tjera që kanë bërë qytetarët.

Pra sa i përket komisionit për vlerësimin e këtyre figurave dhe kërkesave të ndryshme, unë plotësisht jam në dakord dhe për këtë kërkova që kjo çështje të futet si pikë shtesë e rendit të ditës dhe në mbledhjen e Kuvendit ta marrim një vendim për formimin e një komisioni të tillë i cili pastaj do të mund ta vlerëson secilën figurë / personalitet dhe secilën kërkesë që mund të paraqitet.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bëri të marr fjalën Drejtori i DKRS, i nderuar drejtor për instalimin e shtatoreve në hapësira publike për nga ana ligjore dhe me Hartë Zonale jam në dijeni se është e paraparë se ku mund të ndërtohen dhe destinimi i asaj parcele. Të vësh shtatore në territorin e Komunës së Podujevës par miratim nga Kuvendi i Komunës për lokacion dhe pa dëgjime publike është shkelje.

z.Pajtim Balaj, Drejtor i DKRS, theksoi, nuk po pretendoj se jam në njohuri me ligjet mirëpo unë po i referohem një dokumenti të Nivelit Qendrorë të cilin mund t'jua siguroj si kopje në fund të këtij takimi.

z.Naim Çunaku, theksoi, për caktimin e lokacioneve për projekte të DKRS kemi pas propozime në Kuvend dhe janë marr vendime nga ky Kuvend, projekt është edhe vendosja e shtatoreve.

z.Pajtim Balaj, Drejtor i DKRS, theksoi, lidhur me ato propozime që janë sjellë në Kuvend për lokacione, kanë qenë procedura të kaluarës dhe është dashtë të ketë një vendim të Kuvendit për të ridestinuuar dy lokacionet për të cilat sigurisht që u aludua.

z.Naim Çunaku, theksoi, qysh guxon dikush t'i jep të drejtën vetes që pa diskutim publik dhe pa vendim të Kuvendit, të marrë vendime që reflektojnë tek qytetarët. Pa ngjyrimë politike sepse ato kanë përfunduar dhe tani jemi duke diskutuar si Komunë dhe si organ më i lartë i saj që është Kuvendi i Komunës, andaj e them se duhet të jemi shumë të kujdesshëm në këtë aspekt dhe të mos polarizojmë dhe ta bëjmë ndokënd të ndihet keq për ndonjë projekt, pra duhet pyetur qytetari përmes konsultimeve publike se a e pranon atë projekt apo jo, a është në të mirën e tij, apo është për qëllime të caktuara dhe kjo është demokracia që po pretendojmë dhe kjo është afrimi i qytetarëve në vendimmarrje, përndryshe në të ardhmen do të vijmë në një situatë ku një drejtor sot vë diçka, kurse nesër vie një drejtor tjetër i cili vendos diçka tjetër, e që mendoj se kjo është lojë e rrezikshme.

z.Pajtim Balaj, Drejtor i DKRS, theksoi, unë nuk kam vepruar krye në vete por ka një dokument të Nivelit Qendrorë dhe atë do t'jua siguroj pas këtij takimi, kështu që do ta vëreni se nuk kemi punuar ashtu vetëm pse kemi dashtë.

z.Haki Rudari, theksoi, fillimisht e them se nuk është mirë ta dalim nga rendi i ditës dhe tema të cilën kemi por të ndalemi konkretisht për temën që kemi përballë. Edhe njëherë po e them se nuk ka filtër më të lartë, më të mirë dhe më ligjor se sa Kuvendi i Komunës sepse këshilltarët e Kuvendit janë zgjedh nga vota e qytetarëve. Gjithashtu mund të them se është një dallim në mes të shpalljes Qytetar Nderi dhe emërtimit të një rruge me emrin e Doris Pack, prandaj sa i përket emërtimit të rrugës ne mund të debatojmë dhe të formojmë komisione, ndërsa sa i përket shpalljes Qytetare Nderi nuk kemi kurrfarë pengese ligjore në këtë drejtim. Edhe njëherë po e theksoj se ne disa që jemi paksa më të moshuar jemi në dijeni për aktivitetin, veprimtarinë, humanitetin, politikën e Doris Pack në vitet e 90-ta, dhe në këtë drejtim mënojmë se jemi të pajimit 100%, prandaj i nderuar Kryesues i Kuvendit edhe njëherë propozoj që të

hedhet në votim kërkesa në fjalë që pastaj t'i shkoj si rekomandim Kuvendit të Komunës sepse edhe ashtu si KPF nuk kemi të drejtë të marrim vendime por vetëm t'i rekomandojmë Kuvendit çështje të ndryshme dhe ai është organi i cili vendos për çështjet.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë çështje unë ju dhashë hapësirë më shumë të gjithëve të diskutojmë dhe u vërejt nga të gjithë se qëllimi është se si të dalim sa më mirë të jetë e mundur dhe duke marrë për bazë këtë unë edhe lejova të dalim paksa nga Rregullorja e punës së Kuvendit.

Pra meqë qëllimi ishte i mirë nga të gjithë, ne mund t'i rekomandojmë Kuvendit që të jetë pikë shtesë e rendit të ditës, të diskutohet dhe deri atëherë mund të analizojmë se a është e nevojshme që paraprakisht të formohet një komision për këto çështje siç janë këto kërkesa për shpalljen Qytetar Nderi, por jo për shtatore sepse është diçka tjetër, prandaj kërkesat janë për shpalljen Qytetar Nderi, mblidhet ai komision dhe e shqyrton dhe analizon. Në fakt ne kemi një arsytim për këtë çështje që është bërë nga Klubi Politik "Afrim Zhitia" mirëpo nuk do të thotë se është arsyetuar e gjitha dhe nuk do të thotë se duhet të jetë vetëm ashtu siç është cekur lidhur me personalitetin Doris Pack. Pra këtë çështje mund ta diskutojmë në mbledhjen e Kuvendit që është caktuar për datën 15.05.2023, andaj nëse nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën unë e hedh në votim që kjo kërkesë të hynë si pikë shtesë në kuadër të rendit të ditës si dhe e njëjta t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 8 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 1 votë e Përmbajtur, mbështetet kërkesa për përfshirje në kuadër të rendit të ditës për këtë mbledhje dhe që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim si pikë shtesë Kërkesa e Klubit Politik "Afrim Zhitia", të proceduar nga Kryesuesi i Kuvendit – Komitetit që ish zonja eurodeputete Doris Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe të bëhet emërtimin i një rruge kryesore me emrin e saj.

Kryesuesi i Komitetit, vazhdoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth rendit të ditës, nëse jo atëherë e vë në votim rendin e propozuar të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, përfshirë edhe pikën shtesë të mbështetur paraprakisht.

Pas votimit, Kryesuesi i Komitetit konstatoi se me 8 vota Për, asnjë votë Kundër dhe 1 votë e Përmbajtur, miratohet rendi i propozuar i ditës sipas thirrjes dhe materialit të dërguar për këtë mbledhje, si dhe duke përfshirë pikën shtesë, dhe atë;

- Kërkesa e Klubit Politik "Afrim Zhitia", të proceduar nga Kryesuesi i Kuvendit – Komitetit që ish zonja eurodeputete Doris Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe të bëhet emërtimin i një rruge kryesore me emrin e saj.

1. Propozim vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore.

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, për këtë pikë të rendit të ditës ka qenë e paraparë ta prezantoj Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, mirëpo nga ai jam lajmëruar që ka takim me Auditorin e Përgjithshëm dhe nuk mund të jetë prezent, mirëpo drejtori i DKRS është këtu prezent dhe mund ta paraqes një fjalë hyrëse në emër të Ekzekutivit të Komunës.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, besoj se materialet përkatëse i keni marrë me kohë, kërkohet që ky propozim vendim t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim. E tërë përmbajtja e propozim vendimit konsideroj se është theksuar në propozim andaj mund të diskutohet dhe të kaloj në Kuvend për shqyrtim.

z.Naim Çunaku, theksoi, është një praktikë e cila është ndjekur edhe në të kaluarën dhe që nuk mund të anashkalohet si proces i bartjes së të hyrave vetanake duke pas parasysh muajt e fundit të vitit kur vetëm përfundojnë aktivitetet financiare. Vërtetë është që ndoshta nuk jam i kënaqur me sasinë e cila ndoshta

është mbet pa u shpenzuar mirëpo këtë ligji e mundëson dhe atë sasi duhet ta bartim dhe ta shfrytëzojmë në këtë vit që jemi. Për mua e diskutueshme është ndarja dhe projektet që janë paraparë nga ana e Drejtorit të DBF por me vet faktin që drejtori në fjalë nuk është prezent këtu, neve nuk na mbetet asgjë tjetër përveç që t'i rekomandojmë Kuvendit për shqyrtim këtë pikë të rendit të ditës.

z.Haki Rudari, theksoi, Grupi i LVV-së e përkrahë këtë propozim vendim, përkatësisht që të hyrat e cekura të barten në vitin 2023 në shumë prej 626,613.46€ të cilat barten në programe siç janë Administratë komunale 360,983.42€, në Shëndetësi 20,096.25€, si dhe në Arsim është një shumë bukur e mirë prej 245,533.79€, mendoj se janë në projekte të cilat janë në interes të qytetarëve, prandaj edhe ne besojmë dhe i japim mbështetje që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

z.Bashkim Syla, theksoi, natyrisht që bartja e të hyrave vetanake të pashfrytëzuara nga viti 2022 në vitin 2023, zakonisht që edhe viteve të kaluara ne i kemi përkrahur bartje të tilla nga viti në vit dhe do ta përkrahim edhe këtë edhe pse për këtë propozim vendim kam disa pyetje por meqë Drejtori i DBF nuk është prezent këtu do t'ia paraqes në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, prita nga shefi i Grupit të LVV-së z.Haki Rudari që ashtu siç kemi diskutuar kur ka qenë projektbuxheti i Komunës për shqyrtim dhe miratim, e ka pasë një propozim që një mundësi ligjor të cilën Kuvendi nuk e shfrytëzon. Dua të them se është dashur ose nga kolegu i cekur ose nga ti Kryesues që për Kuvendin e Komunës së Podujevës në fondin e vet nuk asnjë shumë buxhetore, dhe është thënë që kur të bëhet ridestini i mjeteve në rend të parë ata që nuk mendojnë as për vete e që në këtë rast po del të jemi ne, kështu që unë propozoj që nga destini i këtyre të hyrave vetanake për shfrytëzim në vitin 2023 të kemi një sasi nga këto mjete të cilat do të parashihen në kodin buxhetor të Kuvendit të Komunës, për çka kolegu z.Haki Rudari kishte kërkuar shumën prej 5,000.00€, ndërsa unë tani propozoj që minimumi i kësaj shume të jetë 20,000.00€ të barten në fondin e Kuvendit.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, lidhur me këtë propozim vendim kemi të bëjmë me bartjen dhe destinimin e mjeteve të pashfrytëzuara nga viti 2022 në vitin 2023 sepse ato mjete nuk mund dhe nuk duhet të mbesin në atë gjendje prandaj edhe barten në vitin aktual.

Propozimi i kolegut z.Naim Çunaku është i mirë që edhe Kuvendit t'i barten mjete buxhetore, madje nuk e di qysh është paraparë nga niveli qendrorë mirëpo me rritjen e pagave për anëtarët e Kuvendit që ka ndodh ne nuk kemi buxhet as për 6 muaj nëse nuk bëhet një zgjidhje prej administratës apo ndokujt tjetër sepse ne me ato paga që kemi qenë në shumë pak mbi 200€ në muajt kemi planifikuar buxhet, mirëpo tani pagat tona janë trefishuar pothuajse e që mund të ndodh të paraqiten probleme.

Nuk e di drejtori i DBF sa ka paraparë mjete për këtë çështje, andaj sa do pak është mirë që edhe propozimi i kolegut z.Naim Çunaku të merret parasysht.

z.Bashkim Syla, theksoi, nëse propozohet një shumë prej 20,000.00€ që të bartet në kodin e Kuvendit atëherë duhet të propozohet edhe nga cili kod duhet të merren ato mjete, kështu që sot nuk po e shoh të arsyeshme të merret qëndrim për këtë propozim.

z.Naim Çunaku, theksoi, mund t'ju them se sa i përket propozimit tim nuk pati lojë politike, mirëpo mund të them se gjatë angazhimit tim në këtë organ, deri në vitin 2013 nuk kemi pas kod buxhetor si Kuvend dhe kemi lobuar dhe kemi avokuar që Kuvendi i Komunës në kuptimin e funksionimit dhe rëndësisë së tij ta ketë edhe kodin e vet buxhetor, andaj krejt në funksion të kësaj e pata atë propozim që do të ishte e pakuptueshme që Kuvendi i Komunës kodën e vet buxhetor ta ketë zero zero, nëse për juve është e kuptueshme atëherë mund ta vazhdojmë s'ka kurrfarë problemi.

Është bërë një praktikë ku dalin lajme dhe njoftime në faqen zyrtare të komunës dhe jo vetëm duke thënë se Komuna ndau NN mjete buxhetore për këtë dhe atë projekt apo aktivitet, mirëpo unë ju them se nuk ndan Komuna e as Ekzekutivi i Komunës mjetet buxhetore, madje Ekzekutivi i Komunës është vetë ekzekutues i buxhetit kurse Kuvendi i Komunës është ai i cili ndan buxhet dhe destinon mjete buxhetore për projekte të caktuara, kështu e thotë ligji, por ato gjëra po bëhen në formën qysh këtyre jua merr

mendja dhe jemi në rregull. Më pengoj ajo që Kryesuesi i Kuvendit e potencoj se do ta pyesim drejtorin e DBF-së, nuk jemi ne ata që i japim llogari apo që e pyesim drejtorin. Drejtori i jep llogari Kryetarit të Komunës, pastaj Kryetari Kuvendit të Komunës. Propozimi im ishte që nga këto mjete të parapara të ndahet shuma prej 20,000.00€ dhe të destinohet në kodin e Kuvendit, kurse prej cilit kod merret ajo shumë, nuk e kam atë problem unë nga ku merren, prej cilitdo kod të merren se kam atë problem, mirëpo ta zëmë mund të ndahen nga programi administratë komunale ku janë paraparë 360,983.42€, edhe ashtu jemi të ndërlidhur me administratën, prandaj vetëm të jenë të përcaktuara në kodin e Kuvendit të Komunës. Pra kjo shumë të zvogëlohet për 20,000.00€ dhe këto mjete ishte propozim i imi që të kalojnë në kodin e Kuvendit, nëse dëshironi ne pastaj edhe mund ta rrisim këtë shumë.

z.Bashkim Syla, theksoi, unë nuk kam kurrfarë qëllimi, as politik as sa për të bërë debat mirëpo për shkak se drejtori i DBF-së nuk është prezent këtu unë e potencova që këtë propozim ta bëni në seancën e Kuvendit. Pra unë nuk e thash këtë me kurrfarë konotacioni politik por me sinjeritetin më të madh jua thash këtë, por ti (i drejtohet z.Naim Çunakut) e keqkuptove dhe e keqpërdore, në rregull është kjo, mirëpo unë isha shumë i drejtpërdrejt dhe e potencova që vetëm për shkak të mungesës së drejtorit të DBF e kam ngase kur ka ndryshime normal se duhet të ndryshohen edhe dokumentet përkatëse edhe të sjellët dokumentacioni i ri dhe t'iu dërgohet edhe anëtarëve të Kuvendit, kështu që është një procedurë dhe është një rregull lidhur me këtë çështje.

Pra për këtë arsye e thash që mund të presim që këtë propozim ta bëni në seancën e Kuvendit ku edhe anëtarët e Kuvendit pastaj kanë mundësi ta analizojnë dhe ta votojnë për ose kundër.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk pretendoj dhe nuk dëshiroj të ndërtoj ura shkëputëse ose mosbashkëpunim me Ekzekutivin e Komunës sepse fundja një qeverisje e suksesshme është se sa ka ura të bashkëpunimit mes tyre, mirëpo gjithsecili në rolin e vet, ai në rolin e Ekzekutivit, unë në rolin e anëtarit të Kuvendit ashtu siç jam i mandatuar. Ajo që mua më vrau nëse mund ta them kështu është se është bërë praktikë me vite e vite kjo shprehja, po thotë drejtori, prandaj me gjithë respektin për punën dhe kompetencën e drejtorit, por jo në kompetencë timen sepse ne bëjmë ndarje buxhetore.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj se debati për këtë çështje përfundoj, andaj e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës përfshirë edhe propozimin e z.Naim Çunakut.

Me 5 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 1 votë të Përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozimi vendimi për bartjen e të hyrave vetanake të Komunës së Podujevës nga viti 2022 në vitin 2023 dhe destinimin në kategori dhe programe të caktuara buxhetore, përfshirë edhe propozimin e z.Naim Çunaku që 20,000.00€, nga programi Administratë Komunale, në shumë 360,983.42€, të barten në kodin buxhetor të Kuvendit të Komunës.

2. Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës - Lokale afariste në Tregun e Qytetit.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, më lejoni që bazuar në Ligjin nr.06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës si dhe Rregulloren (QRK) nr.09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, e paraqes propozim vendimin për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës e që janë Lokalet afariste në Tregun e Qytetit, në parcelën 244-1, Zona kadastrale Podujevë.

Ne si DPKGJ kemi filluar me përgatitjen e propozim vendimit për pronat përkatëse të cilat janë në përgatitje për dhënie në shfrytëzim nga ana e Komunës të cilat jepen në shfrytëzim nga Komuna me qëllim të realizimit të interesit publik, krijimit të vendeve të punës dhe të të hyrave materiale, andaj e paraqes para KPF-së për shqyrtim dhe miratim.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, ne Grupi i LVV-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës dhe njëkohësisht e rekomandojmë për në seancën e radhës së Kuvendit, duke marrë parasysh edhe qëllimin e këtij propozimi që është për qëllime afariste, krijimin e vendeve të punës si dhe rritjen e të hyrave vetanake.

z.Naim Çunaku, theksoi, ne kemi disa dilema të cilat po besoj se edhe Drejtori i DKRS-së dhe drejtoresha e DPKGJ mund të na sqarojnë. Në atë lokacion janë disa lokale që janë ndërtuar në të kaluarën dhe të cilat kanë mbetur ashtu siç kanë mbetur për çka jemi dëshmitar të gjithë se në çfarë gjendje janë. Në një hapësirë publike siç janë ato lokale, janë duke u degraduar nga mos shfrytëzimi i tyre e që nuk mendoj se e kemi komoditetin gjegjësisht operimin ekonomik që një hapësirë çfarë janë ato lokale t'i lëm të pashfrytëzuara as për të mirën e ekonomisë private / individuale apo shfrytëzimit të tyre nga institucionet që kanë nevojë për ato hapësira, mirëpo dilema ime në kuptim të sqarimit është se ne kemi marrë vendim për një Qendër Multifunkionale. Pra si është menduar për atë hapësirë që është e destinuar për treg, a është specifikisht e menduar, edhe pse jam në dijeni se në kushtet e hapjes së ofertave, çfarë mendojmë ne se kush mund t'i merr në shfrytëzim dhe a mos po bëjmë ndonjë gjë që pastaj atakohen mes vete në kuptimin funksional tregu me përfituesit potencial të asaj hapësire.

E përkrahim që duhet të vëhet në shfrytëzim çdo investim që është bërë në funksion të zhvillimit dhe po besoj se në atë vazhde është edhe ajo që të jepen në shfrytëzim ato prona dhe të mos mbeten të pashfrytëzuara ato lokale dhe në atë gjendje për të mirën e askujt, prandaj ne e përkrahim mirëpo vetëm dua të sqarohem, ndoshta konkretisht nga Drejtoresha e DPKGJ rreth dilemës se kur të bëhen specifikisht dhe të vëhen ofertat publike për ata që dëshirojnë të marrin në shfrytëzim, a duhet të kemi parasysh që operatorët konkurrues specifikisht në kushtet e aplikimit të bëhen përcaktimet e veprimtarive që lidhen me tregun sepse pastaj ndoshta na del diçka tjetër si pengesë njëri me tjetrin.

Nga Drejtori i DKRS e mora përgjigjen kur e tha se është ngjitur dhe po e kuptoj si është (fjala është për parcelën e ndarë për Qendër Multifunkionale dhe atë ku gjenden lokalet e Tregut që Qytetit.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, përgjigje parafolësit, theksoi, Lokalet në fjalë janë brenda hapësirave të tregut të qytetit dhe janë të destinuara për aktivitete biznesore tregtare, ndërsa sa i përket dhënies në shfrytëzim është komisioni vlerësues ai i cili vlerëson kërkesat / ofertat përkatëse, kështu që këtë çështje i'a lëm komisionit i cili sigurisht se do t'i përcakton ato çështje.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, theksoi, vetëm deshta të jam një plotësim në këtë aspekt sepse më ka ra të merrem me çështje të tilla sa kam qenë drejtor i DPZHE. Tek çështja e Tregut ka qenë goxha një kaos, DPKGJ është marrë me atë Treg dhe ka lëshuar me qira ato lokale, ndërkohë ka qenë DSHPMSH që është marrë me pjesën e Tregut të Gjelbër e pastaj edhe DPZHE, do të thotë ka qenë një lloj kaosi në kompetenca dhe në menaxhim të tyre dhe për këtë arsye kanë ndodh edhe shumë keqkuptime sa i përket destinimeve të atyre lokaleve. Realisht pjesa e brendshme e asaj hapësire është kryesisht për rroba dhe gjësende tjera, pjesa e jashtme është treg i gjelbër kurse në mes të hapësirës është një korridor i cili ka qenë i destinuar për produkte të qumështit (bylmet). Tani i bie si kjo pjesa e destinuar për produkte të qumështit e ndan pjesën e tregut prej Qendrës Multifunkionale, kurse tregu i gjelbër shkon tek Stacioni aktual i Autobusëve që është projekt i së ardhmes.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo atëherë mund t'ju sqaroj se krahas këtij propozim vendimi kemi edhe 2 komisioni të cilat duhet të formohen me nga 5 anëtar/e, komisioni vlerësues, dhe komisioni i ankesave. Andaj meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë propozim vendim sipas kësaj pike të rendit të ditës dhe materialit përkatës të dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje.

Me 8 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për miratimin paraprak për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokale afariste në Tregun e Qytetit.

3. Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokalet afariste në tregun e Qytetit.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, ne kemi bërë një thirrje publike për plotësimin e përbërjes së anëtarëve, përkatësisht duhet të jetë një anëtar nga Shoqëria Civile. Është një person i cili ka aplikuar, fjala është për z.Agron Kulla i cili pra siç e cekta ka aplikuar për anëtar i këtij komisioni nga radhët e Shoqërisë Civile, kurse anëtarët e komisionit nga radhët e Ekzekutivit të Komunës, me propozim të Kryetarit të Komunës janë drejtorët z.Bahri Selimi-DSHPMSH dhe z.Leutrim Krasniqi-DPUMM, ndërsa edhe 2 anëtar duhet të jenë nga radhët e Kuvendit të Komunës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, Drejtoresha parafolëse i bëri propozimet këtu në këtë mbledhje dhe asgjë nuk ka të keqe por kanë mund të propozohen edhe në mbledhjen e Kuvendit. Si do që të jetë emrat e të propozuarve nga radhët e Ekzekutivit të Komunës dhe emri i propozuar nga radhët e Shoqris Civile i kemi, ndërsa emrat e anëtarëve nga radhët e Kuvendit sigurisht se do të jepen në mbledhjen e Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, kemi hyrë në një procedurë që Ligji e përcakton në këtë formë, emrat do propozohen në mbledhjen e Kuvendit. Jam në dijeni për përbërjen e komisionit në fjalë, mirëpo do të doja nga drejtoresha e DPKGJ të na tregoj se a ka pas më shumë emra / konkurrent nga Shoqëria Civile apo janë vetëm këta dy emra. E them këtë ngase kur të sjellët në Kuvend atëherë krijohet një alternativë, me mbështet, mos me mbështetë ose me zgjedh, kurse tani neve si Kuvend po na jepet vetëm një alternativë e që është, me zgjedh, ndërsa po na eliminohen alternativat tjera kur ne natyrisht nuk jemi në dijeni nga cilat OJQ janë ata, dhe sa prej tyre kanë qenë të interesuara që të jenë pjesë e këtij komisioni.

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, unë në seancën e Kuvendit do t'i sjellë CV-it e tyre dhe licencat që kanë marrë nga OJQ për të qen anëtar në këto dy komisione, ndërsa për aq sa kam informata nga Zyra e Informimit dhe nga Zyra pritëse, janë vetëm dy emra të propozuar nga Shoqëria Civile dhe atë për nga një për komisionet në fjalë.

z.Haki Rudari, theksoi, edhe ne Grupi nga radhët e LVV-së e përkrahim këtë propozim vendim. Natyrisht se themelimin e komisionit e bënë Kuvendi i Komunës, andaj për më shumë dhe për propozimet e emrave do të diskutojmë në seancën e Kuvendit dhe sigurisht se do të themelohet ky komision i cili pastaj ka detyra të përcaktuara me Ligjin për dhënien e pronës në shfrytëzim, janë parimet në kuadër të ligjit e që mendoj se edhe në kuadër të tyre do të punoj ky komision që sigurisht do të themelohet në seancën e Kuvendit të caktuar për datën 15.05.2023.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marr fjalën, unë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit edhe kjo pikë e rendi të ditës.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për formimin e komisionit vlerësues për zbatimin e procedurave për dhënie në shfrytëzim afatshkurtër të pronës së paluajtshme të Komunës- Lokalet afariste në tregun e Qytetit, duke theksuar se emrat e anëtarëve të komisionit do të prezantohen në seancën e Kuvendit.

4. Propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës

znj.Saranda Stublla, drejtoresh e DPKGJ, duke e paraqitur fjalën hyrëse, theksoi, meqë paraprakisht u vendos që emrat të prezantohen në seancën e Kuvendit, atëherë edhe për këtë komision do t'i paraqes në atë seancë emrat e propozuar nga radhët e Ekzekutivit të Komunës dhe nga Shoqëria Civile.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën e hedhi në votim këtë pikë të rendit të ditës.

Me 8 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave në procedurën e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, duke theksuar se emrat e anëtarëve të komisionit do të prezantohen në seancën e Kuvendit.

5. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për vitin 2022

Kryesuesi i Kuvendit, theksoi, edhe për këtë Raport sigurisht se është dashur të jetë prezent Drejtori i DBF, mirëpo siç ju informova më parë ai nuk ka mund të merr pjesë sepse ka takim me disa mysafir, kështu që urdhëroni nëse dëshiron fjalën ndokush nga ekzekutivi i Komunës fillimisht.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, e paraqiti këtë pikë të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, meqë kjo pikë dhe pika vijuese janë pothuajse të ngjashme me dallim të periudhave të ndryshme që raportohet. Pra kjo pikë e rendit të ditës është raporti Financiar për vitin 2022 e që për këtë edhe po të ishte drejtori i DBF këtu nuk do të kishim çfarë të diskutojmë sepse është Kuvendi ai i cili diskuton për këtë pikë e që besoj se do të jetë një prej temave që vazhdimisht zgjat më shumë debat sepse është në interes të Kuvendit të dijë se si shpenzohen mjetet e Komunës, kështu që unë jua propozoj që kjo pikë të kalohet për diskutim në Kuvend.

z.Naim Çunaku, theksoi, Raporti financiar për një vit kalendarik është një prej çështjeve ndoshta më kryesore të një Kuvendi si organ që miraton dhe kontrollon si është shpenzuar. Vetë fakti që drejtori nuk e ka parë të arsyeshme të jetë prezent dhe ka gjetur një angazhim tjetër dhe që e ka cilësuar më të rëndësishëm se KPF-në, e që nuk mund të pajtohem me Drejtorin parafolës por meqë është drejtor i DKRS e tejkaloj disi kur e tha se kjo pikë të debatohet vetëm në Kuvend, po e përsëriti një fjali që e kam cekë para rreth 4-5 muajve këtu, kur kemi parasysh KPF-në dhe aspektin e ligjit që kolegu im z.Haki Rudari po e potencon vazhdimisht se si e përcakton ligji detyrat dhe rolin e KPF-së, nuk është vetëm të rekomandoj por në rend të parë është që të trajtoj, debatoj, të sqaroj, madje shembull, po të ishte prezent drejtori i DBF unë kam pasë pyetje konkrete e që ndoshta e ka pajisë me të dhëna edhe drejtorin që po e zëvendëson tani, pra pyetja është, cila është kostoja që Komuna e Podujevës ka paguar deri më tani për rrugën “Skënderbeu”. Pra kur e kanë paraparë KPF-në nuk e paraparë vetëm për tu mbledhur dhe për të thënë “shkoni ju qatje” por pikërisht jemi një trupë më e ngushtë ku trajtohen në detaje çështjet, pra ky është funksioni i KPF-së, kurse unë sot nuk po mund të marrë përgjigje në një pyetje që e parashtrova, për t’i heq disa dilema e që ka disa dokumente në qarkullim, pra cila është kostoja që është paguar për rr. “Skënderbeu” apo sa i ka kushtuar ajo rrugë Komunës së Podujevës e që dua të marrë shifrën e sakt ngase në dokumente kemi më shumë se 2-3 shifra, andaj më duhet shifra e sakt.

z.Haki Rudari, theksoi, raporti financiar për vitin 2022 realisht është edhe një dokument obligues ligjor që duhet të silltet në Kuvend. Unë pajtohem me kolegun parafolës se në KPF duhet të ketë debat dhe askush nuk e ndalon atë, por fundi i debatit është rekomandimi për seancën e Kuvendit. Pra pajtohem plotësisht që të ketë debat për çdo pikë të rendit të ditës e që kjo parashihet edhe me rregulla ligjore dhe nuk ka kurrfarë problemi. Sa i përket mos prezencës së Drejtorit të DBF, pa dashur ta arsyetoj atë mirëpo ne u informuam se ka në takim delegacion zyrtar – Auditorin gjeneral. Kemi raportin financiar në të cilin janë të përshkruara shumë shpenzime dhe shumë shuma të mjeteve buxhetore për projekte të ndryshme por meqë jemi në mbledhjen e KPF-së dhe nuk jemi ata që marrim ndonjë vendim mirëpo në mbledhjen e radhës së Kuvendit besoj se drejtori i DBF do të jetë prezent dhe do të jep sqarime dhe përgjigje në shumë dilema, shumë pyetje, shumë vërejtje e që sigurisht se do t’i debatojmë në Kuvend.

z.Bashkim Syla, theksoi, pajtoj plotësisht që në mbledhjet e KPF-së duhet të jenë prezent ata drejtor të Drejtorive që kanë pika të rendit të ditës për shqyrtim ngase duhet të trajtohen çështjet, njerëz jemi dhe mund të gabojmë ndonjëherë dhe ndonjë informatë apo ndonjë shifër mund të përmirësohet/korrigjohet këtu në KPF deri në seancën e Kuvendit, pra debati duhet të ekzistoj gjithqysh pavarësisht që ne në disa raste kemi pasë mirëkuptim kur ka qenë në pyetje gjendja shëndetësore e ndonjërit e të ngjashme, mirëpo përdera në disa mbledhje të kaluara të KPF-ës nuk kanë marrë pjesë shumica e drejtorëve të Drejtorive dhe kjo nuk është në rregull, nuk është seriozitet kështu që pajtohem plotësisht me këtë çështje, ndërsa sa i përket Raportit financiar ne i kemi disa pyetje dhe ato do t'i paraqesim në seancën e Kuvendit që është caktuar të mbahet më 15.05.2023.

z.Naim Çunaku, theksoi, pa kurrfarë qëllimi të keq deshta të polemizoj me kolegun parafolës z.Haki Rudari në aspektin që sa ishte ai duke diskutuar neve disave na u qesh, po ajo qeshje ishte me shkas për faktin që kolegu e ceku se drejtori i DBF është në takim zyrtar, por unë pyes ky takim tani ku jemi a është zyrtar, madje kjo mbledhje ka qenë e përcaktuar me datë. Unë në fjalimin tim e thash se ai (Drejtori i DBF) e ka vlerësuar, kurse unë nuk po e vlerësoj se ka bërë drejtë por ai nuk më ka pyetur mua, mirëpo ai e ka vlerësuar që ta anashkaloj KPF-në dhe ta anashkaloj debatin këtu rreth sqarimeve, është në dorën e tij dhe ai ka vendosur.

Atë që kolegu z.Bashkim Syla e potencoj, e kemi trajtuar më shumë se njëherë, vërtetë për mua dh atë jo si Naim Çunaku sepse unë nuk e kam problem të kërkoj qasje në dokumente zyrtare dhe zyrtarisht ai është i obliguar të më ofroj sqarime se përndryshe bënë vepër penale, mirëpo qasja që është duke bërë Ekzekutivi i Komunës e që edhe në fillim e cekëm se në kodin e kuvendit nuk e kemi asnjë cent buxhet, dhe ky trajtim kësi lloji jo serioz ndaj atyre që duhet t'i japin llogari (Kuvendit) për mua është shqetësuese, ata sërish vazhdojnë të njëjtën, Kryetari ka punë me ata, jo unë.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, sa i përket Drejtorit të DBF unë nuk po dëshiroj as ta arsyetoj e as ta mbrojë, mirëpo ai në takim ka Auditorin gjeneral dhe për këtë ka ardh në zyrë dhe më ka njoftuar duke më thënë se nëse lirohem do të marrë pjesë në mbledhje, ky ka qenë arsyetimi i Drejtorit të DBF-së, dhe sërish e them se as nuk po dëshiroj ta arsyetoj e as ta mbrojë. Urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën urdhëroni, nëse jo atëherë e hedhim në votim që kjo pikë e rendit të ditës t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

6. Raporti Financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar – mars 2023.

z.Pajtim Balaj, drejtor i DKRS, e paraqiti këtë pikë të rendit të ditës, ndër të tjera theksoi, edhe për këtë pikë të rendit të ditës, në emër të Drejtorit të DBF propozoj që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e mbajtur më 15.05.2023.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, Grupi i LVV-së e përkrahë dhe e mbështetë që Raporti financiar i Komunës së Podujevës për periudhën janar-mars 2023 t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Qëndrim Softolli, theksoi, kjo pikë e rendit të ditës edhe ashtu është e imponuar që të diskutohet në Kuvend, andaj nuk kemi çfarë të shtojmë rreth kësaj vetëm i rekomandojmë Kuvendit për diskutim.

z.Bashkim Syla, theksoi, meqë përfaqësues nga Ekzekutivi i Komunës është drejtori i DKRS-së do të doja që ta evidenton një çështje për të ciklën kërkohet sqarim, fjala është që në faqe 5 të raportit shkruhet “shpenzimet për tremujorin e vitit 2022”, e që sigurisht është bërë gabim teknik kështu që do të ishte mirë të përmirësohej kjo në mënyrë që të mos vëhen në lajthitje anëtarët e Kuvendit, duke e ditur që sigurisht bëhet fjalë për vitin 2023.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, unë e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e caktuar më 15.05.2023.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

7. Informatë e punës për vitin 2022 nga Njësia e Auditimit të Brendshëm në Komunën e Podujevës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, e paraqit këtë pikë të rendit të ditës, theksoi, si pikë të rendit të ditës që kemi paraparë ta diskutojmë në Kuvend është edhe Informata nga Zyra e Auditorit të brendshëm. Sigurisht jeni në dijeni se Zyra e auditorit të brendshëm është zyrë e cila i jep llogari Kryetarit të Komunës kështu që jemi munduar që brenda specifikave dhe hapësirave ligjore të përgatitim një informatë ashtu siç kërkohet edhe me raportin e performancës, andaj edhe e kemi sjellë këtë Informatë që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim, për çka edhe ju ftoj ta votoni.

z.Naim Çunaku, theksoi, zonja Nënkryetare e Komunës, fjalia juaj kur e potencuat se shkak i raportit të performancës e kemi paraqitur këtë Informatë të auditorit të brendshëm dhe e kemi sjellë në Kuvend, flet gjithçka dhe flet sakt se vetëm atë kusht mund ta plotësoj, pra ky raport/informatë që është dorëzuar sot para këtij Komitetit dhe të hënën para Kuvendit, e arsyeton vetëm atë që Komuna e Podujevës të marrë një pikë në raportin e performancës, përndryshe asgjë përmbajtësore në këtë raport/informatë nuk ka ngase vetëm shpjegohen të drejtat e auditorit të brendshëm, kujt i paraqet raport ndërsa harrohet që plani i punës së kësaj Zyreje duhet të jetë për shqyrtim në KPF e që nuk ka qen asnjëherë.

Edhe njëherë po ju them se ju mirëkuptoj për këtë sepse sakt e ke potencuar që ky është vetëm sa për një kriter për matjen e performancës, e që edhe ashtu jemi keq me performancë dhe për këtë më vie inat kur po e shikoj se ku ta gjej Komunën e Podujevës dhe po më del shumë në fund të rang listës e që vërtetë nuk po ndihem mirë, kurse sa për përfitime nuk po diskutojmë fare ngase edhe Komuna e Rahovecit na ka kaluar dhe atë madje me disa vite rresht përfitojnë miliona euro përfitime nga raporti i performancës.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, unë isha shumë e singertë dhe e potencova se për shkak të raportit të performancës është një Informatë e cila diskutohet në Kuvend.

Raporti i Zyrës së Auditimit të brendshëm është një dokument i cili është më konfidencial dhe ne jemi munduar t'i selektojmë të dhënat të cilat nuk e prekin konfidencialitetin që ka Auditori i brendshëm, do të thotë bukur gjatë e kemi studiuar këtë çështje, madje edhe në vitin e kaluar e kemi diskutuar dhe kemi thënë se tani e tutje do të silltet në Kuvend për diskutim ky raport, mirëpo edhe me rekomandimin e Auditorit të brendshëm kemi arritur ta nxjerrim këtë përfundim të cilin e kemi paravetës.

z.Naim Çunaku, theksoi, me gjithë respektin për Ju zonja Nënkryetare, mirëpo kur një Auditor i jashtëm i vë të gjitha specifikat në një raport nuk ka konfidencialitet tek ai sepse i paraqet publikisht të gjitha të gjeturat. Ne jemi këtu anëtar të Kuvendit të Komunës dhe detyra parësore e Kuvendit në një formë është monitorimi përfaqësimi i asaj që ka vendos vetë se a ke dërguar në destinacionin e duhur dhe a ka praktikuar mirë ai që i'a ke besuar, pra ne si Kuvend këtu me votat tona i'a kemi ndarë X Drejtorisë 1 milion euro, dhe tani duhet ta shikojmë se çfarë ka bërë me ato 1 milion euro, dhe kjo është parësore, ndërsa Auditori i jashtëm këto gjëra si gjeneralë po na i publikon, andaj përderisa Auditori i jashtëm nuk ka fshehtësi prej neve, del Auditori i brendshëm që është i joni si Komunë dhe thotë ka konfidencialitet, dhe atë me kë, me neve si KPF që e ka për obligim të na e sjellë planin dhe madje të jemi bashkë hartues planit të veprimt.

Edhe njëherë e përsërisë që ju përgëzoj për atë që kjo informatë e ka përmbushur si kriter për performancë.

z.Haki Rudari, theksoi, unë mendoj se është vetëm njëra prej arsyeve performanca që ka ardh kjo informatë, madje kur unë kam kërkuar për çdo vite nga 2013 deri në vitin 2018 që të ketë auditim të brendshëm, LDK fare as që tentonke ta themelonte, kurse tani ka ardh ky raport dhe e thonë pse ka ardh. Më lejoni t'i lexoj disa parime të auditimit të brendshëm, ligjshmëria, paanshmëria dhe integriteti, pavarësia dhe objektiviteti, profesionalizmi dhe kujdesi i duhur profesional, dhe e fundit është kompetenca e auditimit, pra kjo në ligj është e paraparë dhe janë tri forma ku bëhet auditimi nëpër Kuvende Komunale e që njëra nga ato është auditimi i brendshëm apo edhe auditimi i jashtëm që pritet të vijë. Pra i nderuar Çunaku, kjo nuk është vetëm në letër sepse në faqen e fundit thuhet, po citoj, në planin vjetor janë planifikuar gjashtë auditime dhe kemi arritur t'i kryejmë të gjitha këto auditime të planifikuara plus një auditim me kërkesë. Për hirë të kohës unë nuk po i lexoj auditimet që janë bërë sepse ato veç i kemi në material.

znj.Marigona Lahu, Nënkryetare e Komunës, theksoi, sa i përket asaj që z.Naim Çunaku e ceku, kemi të bëjmë me dy çështje që janë auditimi i jashtëm dhe auditimi i brendshëm. Auditimi i jashtëm kërkohet me ligj specifikisht ku secili institucion publik, madje edhe ato private duhet ta bëjnë auditimin e jashtëm, dhe në këtë aspekt ne e kemi edhe obligative ta diskutojmë auditimin e jashtëm në Kuvendin e Komunës. Sa i përket çështjes së auditimit të brendshëm, auditori i brendshëm i jep llogari Zyrës së Kryetarit të Komunës, jo të tjerëve, pra përgatit raportet dhe ia dërgon kryetarit i cili pastaj i shqyrton. Nëse Zyra e auditimit të brendshëm merret seriozisht, sigurisht se raportet e auditorit të jashtëm pastaj janë shumë më në rregull.

z.Naim Çunaku, theksoi, besoj se goxha preciz jam në fjalorë, por të më thuhet gjëra që nuk i kam thënë dhe atë të më thuhet në prezencë nuk mund ta tejkaloj këtë. I nderuar Haki Rudari, nuk e thash fare, pse ka ardh raporti, nuk ishte në fjalën time kjo çështje, pra nuk e cilësova as letër as asgjë tjetër por e cilësova raport. Çështja tjetër është se kolegu në fjalë e potencoj se këtë çështje nuk e ka bërë LDK-ja, unë e pyes atë, a mund ta përmbyll një diskutim pa e përmendur LDK-në, këtë e them jo që dëshiroj ta mbroj LDK-në por nisur nga fakti që LDK nuk është duke qeverisur dhe nuk mundemi tani t'i gjykojmë njerëzit që nuk kanë qenë pjesëmarrës sepse nuk kanë qenë të lindur në vitet 60-ta.

LDK ka qeverisur në të kaluarën, është kritikuar, ka dalë para qytetarëve dhe është votuar dhe jemi ku jemi, mirëpo nuk e kemi temë LDK-në, por nëse dëshironi e bëjmë një temë dhe e fusim në rend të ditës ku edhe pastaj mund të diskutojmë për LDK-në, për LVV-në, nuk i ikim asaj, por tani nuk e kemi temë. Edhe njëherë e nderuar zonja Nënkryetare, me gjithë respektin ne sot nuk jemi në mbledhjen e Kuvendit të Komunës por jemi në mbledhjen e KPF-së dhe këtu është një dallim sepse specifikisht ka tjera detyra sipas ligjit raporti KPF me Kuvendin e Komunës, dhe në KPF përmendet auditori i brendshëm e që pastaj del me një raport se çfarë ka audituar.

Për fund po e përmendi edhe një gjë e që do të doja të dëgjonte edhe z.Haki Rudari, ne këtu jetojmë dhe jemi në dijeni se auditorin e brendshëm pa qare duhet ta kemi, kushdo qoftë në qeverisje, ajo zyrë përbëhet prej dy zyrtarëve dhe e pyes zotëri Rudarin a është në dijeni dhe a ka pasë konkurs për ata dy zyrtar, të paktën për njërin prej tyre, a e dinë qysh është ai auditor dhe a e dinë se ai vetë është në cilësi duke bërë shkelje ligjore, prandaj mos më vë në atë "territor" duke thënë letër e andej këndeje.

z.Haki Rudari, theksoi, Kuvendi i Komunës së Podujevës dhe Ekzekutivi i Komunës nuk funksionojnë vetëm prej vitit 2021, por nga viti 2000/2021 kur janë mbajtur zgjedhjet e para lokale pas luftës e që janë rreth 20 vite për të cilat mban përgjegjësi LDK dhe nuk mund t'i ikësh përgjegjësisë, qoftë për të mirë qoftë për të keq, prandaj unë në çdo seancë i referohem LDK-së sepse e ka udhëhequr rreth 20 vite i nderuar z.Naim Çunaku dhe nuk mund t'i ikësh asaj apo duhet të distancohesh publikisht këtu në foltore për atë që LDK e ka bërë për 20 vite dhe atëherë mund të filloni një rrugë të re e që do të ishte krejt në rregull, kurse në njërin anë thua që jam LDK kurse në anën tjetër thua mos e përmend LDK-në për të bëmat, gabimet dhe dështimet që ka pasë, kjo nuk është në rregull i nderuar Çunaku, nuk e kemi ne të dy

as moshën të bëjmë shaka të tilla në Kuvend. Gjithçka që bënë LVV unë e marrë përgjegjësinë, qoftë për të mirë qoftë për të keq dhe nuk e kam problem fare, (ka dështuar ka dështuar), nuk i ikë unë asaj, edhe kur është mirë edhe kur është keq unë e marrë përgjegjësinë.

Sa i përket auditimit të brendshëm, unë nuk i di ato që u cekën, unë vetëm e di çka thuhet në materialin që na është dërguar e që thuhet janë dy zyrtar (auditori i brendshëm dhe drejtori i Njësisë së auditorit të brendshëm) dhe kjo është në dokumentin që na është sjellë dhe unë flasë në bazë të këtij dokumenti. Nuk është në detyrën dhe kompetencat e mia që ta zgjedhë unë atë. Unë e potencova që për vitet 2013 - 2017 i kam 49 procesverbale fizike në shtëpi, pra për të gjitha mbledhjet dhe asnjëherë nuk na është sjellë raport i auditimit të brendshëm, madje kur shkonim nëpër disa trajnime e që prezent ke qenë edhe ti zotëri Çunaku, kam dhënë vërejtje dhe gjithherë kemi qenë të përkrahur duke thënë se auditimin e brendshëm duhet ta ketë Komuna, nëse nuk është kështu demantoje, mirëpo asnjëherë nuk na është sjellë raport apo informatë i auditorit të brendshëm në Kuvendin e Komunës.

Tani kjo informatë që është sjellë, unë lexova gjashtë auditime që janë bërë dhe atë ku thuhet në bazë të planit vjetor dhe kemi arritur t'i kryejmë të gjitha këto auditime, plus thuhet edhe një auditim me kërkesë. Unë për hir të kohës nuk i lexova sepse janë në materiale, por po e them vetëm një, Teatri i qytetit dhe menaxhimi për vitin 2021 është bërë një auditim i brendshëm e që mendoj se kjo është një formë e mirë edhe e transparencës sepse ngritë transparencën, ndërsa a ka vërejtje në rregull është vazhdojeni e thonë atë nuk ka kurrfarë problemi.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk doja të diskutoj asgjë që dal nga tema mirëpo meqë po tentohet jemi të gatshëm edhe për atë, nëse i lejohet ndokujt sigurisht se do të më lejohet edhe mua i nderuar Kryesues i Kuvendit, të flas një person kushdo qoftë ai e që në këtë rast është z.Haki Rudari, dhe të më tregoj mua se si unë duhet të distancohem nga një parti politike është përtej “mashallahut” . unë nuk mund t'i them z.Haki Rudarit distancohu nga LVV sepse është përtej njerëzores kjo. Partia politike dhe bindja politike është personale e imja dhe nuk kam marrë mendim as prej zotëri Rudarit as prej askujt, kurse të më thuhet mua bëne një distancim të tillë, unë e them se atë distancim mund ta bësh ti zotëri Hakri Rudari, por jo unë. Unë nga ajo që jamë në politikë dhe kam këtu kolegë/e siç janë znj.Adelinë Stublla, ti zotëri Rudari, Kryesuesi z.Hilmi Hoxha, e dini se nuk jam shumë rob i shkronjave dhe nuk lidhem fare për shkronja, por parimi është parim dhe unë sot ndihem mirë sepse e kam zgjedh vetë si vazhdimësi e LDK-së si një parti tradicionale që e ka kontributin e vetë në historinë e bërjes së shtetit të Kosovës.

Ku ishte poenta kur e thash që mos e përmend, është se kur e marr raportin financiar dhe çfarëdo raporti tjetër nuk shkruan këtu as viti 2000, as viti 1989 kur është formuar LDK, por po shkruan NN raporti për vitin 2022 dhe në këtu temë e kemi vitin 2022. Nëse dëshiron të hysh në gjenezë se kush ka qeverisur mirë e kush ka qeverisur keq mund të jemi në ndonjë panel, por jo në Kuvend sepse nuk e kemi temë këtë gjë. Prandaj thirrja duke më orientuar të distancohem, jo mor, mund të distancohesh ti zotëri Rudari prej të keqes, mirëpo unë e ndjejë vetën mirë në LDK sepse vetë e kam zgjedh, e kam lënë e pastaj jam kthyer sërish, mirëpo kjo nuk është temë këtu. Ti zotëri Rudari mund t'i japësh vetëm vetit përgjigje, por jo mua asnjëherë.

z.Haki Rudari, theksoi, ne jemi në debat politik, kurse zotëri Çunaku vazhdimisht ku ka ndonjë gjë për kritikë LDK-së thotë jo mos e përmend, jo këtu jo aty. Unë e thash se nëse ti tani je më mirë se sa kur ka qenë LDK në pushtet, distancohu dhe thuaje, veprimet e LDK-së në këtë kohë deri në këtë kohë kanë qençe jo të mira dhe distancohem. Unë këtë e thash për LVV që nuk e kam fare problem ta bëjë një gjë të tillë, kur është keq do të them se është keq, kur është mirë do ta them se është mirë, mendimet dhe anëtarësitë e njerëzve janë dëshirë e tyre qoftë në LDK, LVV, PDK e të tjera, secili ka bindjet e veta. Prandaj për të gjitha këto, më thuaj i nderuar Çunaku, kur ka ardh Njësia e Auditimit të Brendshëm për diskutim në Kuvendin e Komunës në kohën e LDK-së, kur ka ardh raport në Kuvendin e Komunës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, unë do të doja që prezent të jetë auditori i brendshëm në mënyrë që të na tregoj se çfarë lejohet të na raportoj neve dhe çfarë nuk lejohet, sepse tani për tani unë nuk jam në dijeni për nga ana ligjore këtë çështje.

z.Naim Çunaku, theksoi, nuk deshta të dalë jashtë kësaj teme mirëpo meqë po dëshirohet ne nuk i ikim kësaj dhe këtë e thash edhe më herët. z.Haki Rudari e bëri një pyetje konkrete duke thënë raporti për herë të parë që e ka bërë Kryetari i Komunës, unë e them se në rregull është që e ka bërë tani, në dy vitet e kaluara nuk e ka bërë, kurse në këtë vite po. Ne tani nuk mund ta matim qeverisjen, Kryeshefin Ekzekutiv të pasluftës nëse e vëmë nga ky këndë ku jemi sepse jemi 23 vite mbrapa dhe kemi zhvilluar si shoqëri dhe si demokraci, jemi tjetër tani, mirëpo të kërkohet distancim kurrë kurrë dhe besojë këtë, e them këtë ngase në premtimet elektorale dhe nga ajo që po devijohet kur vijmë në qeverisje, të gjithë po kanë metamorfoza të ndryshme, por në veçanti për mendimin tim (për z.Haki Rudarin mund të mos jetë) metamorfozë më të madhe se LVV-ja, në histori të Kosovës nuk kam parë.

Besojeni se duke u mbështetë në kolegjalitetin unë nuk munda dhe nuk dua ti kap këto elemente sepse e di, i fali, nuk e kanë ditë çka është institucioni por nëse e kanë ditë është gjë edhe më e keqe sepse del që kanë mashtruar andaj nuk dëshiroj të hy në gjëra të tilla, arsyeja është se unë nuk mundem që këtu të ma glorifikosh figurën e Oliver Ivanoviqit, nuk dua sepse nuk ka faj z.Haki Rudari dhe prandaj nuk merrem me këtë, nuk i udhëheqë bisedimet me Serbin z.Haki Rudari prandaj nuk i drejtohem këtij sepse nuk është çështje e tij, e di që Kosova është si rezultat i dikujt tjetër shtet dhe jemi këtu ku jemi, prandaj mos më folni për LDK-në sepse nuk jemi duke debatuar as për vitin 1989 as për 2000 e as për 2020, por jemi duke debatuar për raporte financiare të periudhës njëvjeçare të këtij vitit. A ka qenë një qeverisje e mirë, them nuk ka qenë, ndoshta ka qenë më e mira për kohën, por që tani qytetari ka menduar se nuk është e mirë dhe ka votuar dikë tjetër e që tani jemi duke e trajtuar këtë qeverisje.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë temë unë do ta mbyllja debatin sepse u debatua mjaft.

z.Haki Rudari, theksoi, po ndërlihem me atë që kolegu z.Naim Çunaku e tha, nuk ka qeverisur mirë dhe krejt në rregull është, andaj nuk po e zgjati më shumë debatin.

znj.Marigona Lahu, Nënkrjetare e Komunës, theksoi, po besoj se edhe na edhe ju e kemi qëllimin më të mirë për një qeverisje të mirë për ta pozicionuar mirë Komunën. Auditori i brendshëm, raportet i'a dërgon Kryetarit të Komunës dhe Komitetit të Auditimit të cilin ne e kemi të themeluar. Do të thotë edhe Informata që është sjellë këtu në këtë seancë është për herë të parë dhe është mirë, në rregull ndoshta dikush mund ta konsideroj si të mangët, por njëmend jemi munduar që të mos i përfshijmë ato gjëra që nuk guxojmë të hyjmë, ndërsa Raporti i Auditorit të jashtëm është raport i cili diskutohet gjerësisht sepse është një institucion tjetër i pavarur që bënë auditim të tillë e që në fakt duhet të jetë edhe Zyra e auditorit të brendshëm e pavarur, mirëpo e përsëris që Zyra e auditorit të brendshëm raportet gjashtëmujore dhe vjetore i'a dërgon Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe të njëjtat grumbullohen dhe dërgohen tek Njësia qendrore e auditimit të brendshëm.

Do të thotë kjo është vetëm një informatë vetëm që të tregohet që Zyra e auditorit të brendshëm gjatë vitit 2022 i ka kryer këto / ato punë.

Për informata tjera ju mund të bëni kërkesë për qasje në dokumente zyrtare të cilat pastaj shqyrtohen dhe nëse janë në përputhej me atë se çfarë mundet auditori t'iu ofroj, besoj se pa hezitim do t'jua ofroj.

Kështu që unë besoj se duhet ta vlerësoni këtë që për herë të parë është sjellë dhe po dëshirojmë të bëjmë diçka të mirë për Komunën, madje këtë vetë e kemi diskutuar vitin e kaluar i nderuar z.Naim Çunaku që duhet doemos ta sjellim. Nuk e kemi pas të lehtë as ne këtë çështje dhe kemi pasë diskutim bukur të gjatë edhe me auditorin e brendshëm, edhe me zyrën ligjore, pastaj kemi marrë edhe informata edhe nga jashtë në aspektin se çfarë mundemi ne të sjellim në Kuvend, kështu që ka rezultuar që mund ta sjellim një Informatë e tillë për të përmbushur një kriter të caktuar ligjor që kërkohet tek performanca për shkak se nuk kërkohet diku tjetër. Kështu që e kemi nisë me informatën e auditorit të brendshëm,

muajin tjetër do ta kemi edhe raportin e performancës që do të diskutohet për herë të parë, andaj besoj se janë nisma të mira dhe besoj se secili duhet t'i gëzohet, normale se presim edhe vërejtjet dhe kritikën e secilit për shkak se vetëm duke marrë parasysh këto mundemi t'i përmirësojmë, pa dashur të ndryshojmë qëllimi është i mirë prej të gjitha palëve por vetëm ndoshta mënyra se si nganjëherë po shprehemi nuk po rezulton mirë.

z.Naim Çunaku, theksoi, nga ajo që u tha, unë që në fillim kur e mora fjalën e thash se me vetë faktin që kërkohet prej autoritetit që e matë performancën që ky dokument të jetë pjesë e trajtimit do të thotë ana ligjore është në rregull, është për një performancë të mirë dhe është kriter i performancës së mirë që të sjellët në Kuvend e që këtu besoj se pajtohem, madje e thash edhe në fillim që atë kriter e përmbushë. Po ashtu e thash se bash do të gëzoheshin që edhe Komuna ime të merr sikurse Komuna e Rahovecit nga 1 milion euro enkas buxhet ku do të shtoheshin mundësi për investime për 1 milion euro, pra do të ndiheshin mirë që në raportin e performancës të jemi në 1, 2, 3 vendet e para. Për këtë ndokush mund të thotë se nuk ka qenë asnjëherë, mirëpo të mos mbetemi me atë që nuk ka qenë asnjëherë dhe të mos pretendojmë tani kurrë të marrim vendin e parë.

Sa i përket asaj që z.Haki Rudari e theksoi e që harrova t'a them më përpara, dhe për këtë ndoshta edhe z.Hilmi Hoxha është mirë me memorie, në vitin 2013 kur kemi pasë Raportin financiar ka qenë LDK në pushtet kurse unë kam qenë në opozitë dhe e kam thënë se nuk e trajtoj Raportin financiar për pa i'u bashkëngjitur raporti i auditorit të brendshëm dhe ai i auditimit të jashtëm (këtë mund ta verifikoni në procesverbale) dhe e kemi ndërprerë seancën. Pra kuptojeni se nuk është që vetëm sot po e bëjmë një gjë të tillë, andaj nuk ka ngjyrim këtu dhe mos ma thoni një gjë të tillë, mirëpo duke kritikuar dhe duke kërkuar diçka më mirë konsideroj se po e përmbushi vetën dhe obligimin tim si dhe po e përmirësoj shoqërinë, e që këtu besoj se jemi në rregull.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, konsideroj diskutimi për këtë pikë përfundoj, andaj e hedh në votim që të rekomandohet për diskutim në mbledhjen e Kuvendit.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

8. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, për këtë pikë të rendit kemi të bëjmë me vënie në konsultim publik për këtë dokument i cili është sjellë nga Ekzekutivi i Komunës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse prezent e kemi edhe përfaqësuesin e Zyrës Komonale për Komunitete dhe Kthim-ZKKK i cili dhe mund të na jap sqarime dhe informata rreth këtij dokumenti.

z.Naim Çunaku, theksoi, e kam lexuar dhe analizuar dokumentin në fjalë dhe vetëm dëshiroj t'i përgëzoj për përgatitjen e këtij dokumenti si një punë të mirë.

z.Liman Zeqiri, shef i ZKKK, duke përshëndetur të pranishmit, paraqiti draft dokumentin në fjalë, theksoi, kemi të bëjmë me dokumente bazë, këtë dhe atë që është pikën pasuese, të cilat neve si Komunë dhe si institucione na nevojiten shumë. Fillimisht kemi dokumentin që ka të bëjë me riatdhesimin për njerëzit tanë të cilët kanë migruar në vendet e perëndimit dhe që nuk kanë mundur të rregullojnë dokumentet në ato shtete ku ka jetuar. Në bazë të dokumenteve të hartuara dhe nënshkruara nga Qeveria e mëparshme, më 26 korrik 2010 i kemi përmbushur rezultatet që na janë kërkuar për procesin e liberalizimit të vizave në atë kohë, dhe në kuadër të kësaj janë hartuar edhe plane nga niveli qendrorë dhe nga niveli lokal në mënyrë që të përmbushen kriteret tona e që në bazë të këtyre kemi punuar dhe vepruar që ato standarde ne si Komunë respektive t'i sqarojmë dhe të punojmë ato.

Për dallim nga dokumentet e mëparshme, këtij dokumenti i është shtuar edhe integrimi i të huajve, e që ndoshta ndokush mund ta merre këtë me hutë mirëpo duke parë trendin e ri global që po ndodh me migrimin, në bazë të Kushtetutës së Kosovës migrimi është i aplikueshme edhe për azilkërkuesit që vijnë nga vendet e konflikteve apo luftërat e ndryshme, bindjet politike apo nga regjione të ndryshme, atëherë trajtohen edhe këto raste të cilat thuajse më shumë ka qendrat tjera siç janë Prishtina, Lipjani e të tjera, por që ndoshta në të ardhmen pritet të ketë edhe në Komunën tonë, andaj kemi qenë të detyruar që në këtë plan të përfshihen edhe ajo kategori.

Normale që është një dokument mjaft i rëndësishëm edhe dokumenti në pikën pasuese i cili ka të bëjë me integrimin e komuniteteve jo shumicë RAE, çështje për të cilën ju them shumë sinqerisht se në bazë të përvojës time që kam në këtë zyrë dhe në Komitetin për Komunitete, Komuna e Podujevës ka qenë një prej komunave e cila njihet edhe në kuadër të Republikës së Kosovës, si komuna më e qetë, më stabile për integrimin e komuniteteve jo shumicë, dhe shpesh herë në bazë të diskutimeve që kemi pasë kemi ardh deri te përfundimi që ne jemi Komuna më e qetë dhe që pasluftës nuk ka pasur asnjë eksces apo incident. Madje janë edhe disa fusha që i kemi përfshirë kur shpesh kemi thënë se të mos quhen fare komunitet jo shumicë por t'iu referohemi që ne si qeverisje lokale jemi në shërbim të drejtë për të gjithë qytetarët në mënyrë të barabartë dhe në këtë aspekt është fusha me nr.6-diskriminimi e që vazhdimisht e ka përdorë duke thënë se ka diskriminim pozitiv.

Unë jam falënderues edhe ndaj Drejtorive përkatëse për bashkëpunim e në veçanti Drejtorinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale në kuadër të të cilës është sektori i strehimit dhe ai i çështjeve sociale që janë kategoritë më të ndjeshme e që çdo herë i është dhënë përparësi dhe janë ndihmuar dhe që asnjëherë nuk ka pasë ndonjë kërkesë shtesë apo ndonjë ankesë por gjithmonë kanë qenë falënderues e që publikisht e falënderoj këtë Drejtori, Drejtorinë e Arsimit dhe gjitha Drejtoritë tjera që kanë dhënë kontribut në hartimin e këtyre dokumenteve ashtu siç kërkohet të jenë.

Në kuadër të këtij plani është i ngritur edhe Komiteti lokal veprues në kuadër të Komunës dhe i cili përbëhet nga të gjithë akterët që punojnë nëpër Drejtori dhe shërbime tjera përkatëse që merren edhe me këtë fushë, siç janë Arsimi, Shëndetësia, Punësimi, Mirëqenia Sociale, Banimi, Infrastruktura, mediat, Kultura, Rinia, Sporti si dhe fusha e diskriminimit.

Për të mos e zgjatë më shumë mund t'ju them se ashtu edhe siç e keni parë këto janë dokumente që duhet të dalin fillimisht në konsultim publik dhe pastaj sërish kthehen në Kuvend për miratim përfundimtar. Nëse ndokush ka ndonjë pyetje, sqarim, vërejtje apo propozim urdhëroni ju mirëpres.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, falënderoj shefin e ZKKK për sqarimet dhe prezantimin e kësaj pike të rendit të ditës por edhe pikës pasuese të rendit të ditës.

znj. Sebastina Vokrri, theksoi, fillimisht e falënderojmë zyrtarin e nderuar parafolës për këtë sqarim kaq të detajuar. Grupi i LVV-së e përkrah propozim vendimin për vënie në konsultim publik Propozim Planit Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025, dhe njëkohësisht i propozon që i njëjti t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim në mbledhjen e caktuar për 15.05.2023.

z. Bashkim Sylja, theksoi, unë personalisht e di sepse kam qenë për 4 vite anëtar i Komitetit për Komunitete dhe kemi bashkëpunuar shumë me z. Liman Zeqirin si shef i ZKKK në Podujevë, dhe në këtë aspekt e di se çfarë angazhimi është bërë për t'iu ndihmuar komuniteteve jo shumicë në Komunën e Podujevës qoftë në aspektin e shkollimit ashtu edhe në aspektin e ndihmave të ndryshëm përfshirë edhe pakot ushqimore, mirëpo të gjithë jemi në dijeni se problemi kryesor është tek prona si një prej problemeve që nuk kemi mundur të sigurojmë donacione për ndërtimin e shtëpive për familjet e komuniteteve jo shumicë ngase ata nuk kanë prona në emër të tyre dhe kjo paraqet problem në këtë aspekt, kështu që edhe njëherë e përsërisë se angazhimi i z. Liman Zeqirit ka qenë shumë i madh dhe

sigurish vazhdon të jetë i njëjtë për çka e falënderoj shumë dhe natyrisht se ne do t'i ndihmojmë në aspektin e shtyerjes përpara të këtyre dy pikave të rendit të ditës (pikat 8 dhe 9).

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, atëherë meqë nuk ka të lajmëruar për të marrë fjalën, e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës që ti rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani Komunal për ri integrimin e qëndrueshëm të personave të riatdhesuar dhe integrimin e të huajve në Komunën e Podujevës 2023-2025.

9. Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, gjithashtu parafolësi z.L:iman Zeqiri shef i ZKKK në fjalën hyrëse rreth pikës paraprake, bër sqsriemt e nevojshme edhe për këtë pikë të rendit të ditës, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën, nëse jo e hedh në votim këtë pikë të rendit të ditës sipas thirrjes dhe materialit përkatës, që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtur i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim dhe miratim Propozim vendimi për vënie në konsultim publik Propozim Plani i veprimit për integrimin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian 2023-2026 në Komunën e Podujevës.

10. Raporti informues i ecurive të punës në Drejtorinë e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë.

znj.Saranda Stublla, Drejtoresh e DPKGJ, e paraqiti fjalën hyrëse rreth kësaj pike të rendit të ditës, theksoi, kemi përgatitur Raportin informues mbi ecurinë e punës së DPKGJ sipas planit të punës së Kuvendit, material të cilin jua kemi dërguar me thirrjen e kësaj mbledhje andaj meqë nuk ka nevojë të ketë votim për këtë pikë, përveç që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim, kërkoj që si e tillë të mbështet për diskutim në mbledhjen e radhës së Kuvendit.

z.Naim Çunaku, theksoi, më bëri përshtypje ajo që drejtoresha e i'u referuar planit të punës së Kuvendit ngase në këtë Ekzekutiv është hera e parë që një Drejtor/esh ka dashur të harmonizoj aktivitetin e saj në bazë të planit të punës së Kuvendit. Edhe pse nuk e kam lexuar fare materialin në fjalë, por besoj se deri në mbledhjen e Kuvendit do ta lexoj dhe analizoj, mirëpo të përgëzoj për vetë faktin që i'u ke përgjigjur planit të punës së Kuvendit të Komunës.

znj.Drita Pajaziti, theksoi, edhe ne Grupi i LVV-së e përkrahim që t'i rekomandohet kjo pikë e rendit të ditës Kuvendit për mbledhjen e caktuar më 15.05.2023.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim

11. Raporti i Punës së Drejtorisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale për periudhën janar-prill 2023.

znj.Adelinë Stublla, Drejtoresh e DSHMS, e paraqiti këtë raport, theksoi, edhe kjo pikë e rendit është sjellë sikurse pika paraprake duke marrë për bazë planin e punës së Kuvendit.

Është bërë një përmbledhje e punës gjatë këtyre muajve për DSHMS duke përfshirë Qendrën Kryesore të mjekësisë Familjare QKMF, dhe Qendrën për Punës Sociale QPS. Pra është bërë një përmbledhje e punëve dhe projekteve gjatë këtij tremujore, kështu që kërkojmë t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim në mbledhjen e radhës në mënyrë që t'i marrim kritika, vërejtjet eventuale dhe sugjerimet e juaja në mënyrë që pastaj të bëhet një punë më e mirë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale.

z.Naim Çunaku, theksoi, edhe këtë raport e mbështesim që në mbledhjen e Kuvendit ta kemi temë për ta diskutuar, andaj kontributin tonë do ta japim në mbledhjen e Kuvendit.

znj.Sebastina Vokrri, theksoi, edhe ne Grupi i LVV-së e mbështesim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

z.Bashkim Sylja, theksoi, po ashtu edhe ne Grupi i PDK-së e përkrahim këtë pikë të rendit të ditës që t'i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim.

12. Kërkesa e Klubit Politik “Afrim Zhitia” që zonja eurodeputete Dorisc Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe emërtimin e një rruge kryesore me emrin e saj.

Kryesuesi i Komitetit, theksoi, pra kemi edhe këtë pikë të rendit të ditës e cila hyri si pikë shtesë në këtë mbledhje dhe e cila pothuajse u diskutua mjaft në hyrje të kësaj mbledhje, andaj urdhëroni nëse ndokush dëshiron fjalën rreth kësaj pike, nëse jo atëherë e hedh në votim që t'i rekomandohet Kuvendit për shqyrtim të kësaj kërkesë në mbledhjen e caktuar për 15.05.2023.

Me 9 vota PËR, 0 vota KUNDËR, 0 vota të Përmbajtura i rekomandohet Kuvendit për diskutim Kërkesa e Klubit Politik “Afrim Zhitia” që ish zonja eurodeputete Dorisc Pack të shpallet qytetare nderi e Komunës së Podujevës, si dhe të bëhet emërtimin i një rruge kryesore me emrin e saj.

Meqë nuk pati të lajmëruar për të marrë fjalën, Kryesues i Komitetit e konstaton të përfunduar këtë mbledhje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00

Procesverbalin e mbajti;

Osman Bajrami

Nr.prot.01-060/04-0032945/23

Podujevë,

12 maj 2023

Kryesuesi i Kuvendit - Komitetit

Hilmi Hoxha